



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 286 Prot.

Tiranë, më 13 . 02 . 2024

### V E N D I M

Nr. 44, Datë 13 . 02 . 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 180 Regj., datë 25.09.2023, e subjektit ankues, Fondacionit “Së Bashku”, kundër Bashkisë Tepelenë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”, të personave me aftësi të kufizuar, lidhur me mungësen e aksesueshmërisë në ambientet e këtij Institucioni.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e hasur prej tyre, duke parashtruar se, ndërtesa e Institucionit të Bashkisë Tepelenë, nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, gjë që i vë ata në kushtet e diskriminimit, duke i mohuar të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e ofruara nga ky institucion në mënyrë të denjë e të barabartë me të tjerët, në respektim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, si dhe VKM-së nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

<sup>1</sup> Referuar dokumentacionit respektiv, Fondacioni “Së Bashku” mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (PAK, përfshirë dhe personat që janë përdorues të karriges me rrota, për shkak të aftësisë së kufizuar apo paaftësisë lëvizëse të tyre).

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Konstatimin e diskriminimit dhe përmirësimin e situatës dhe plotësimin e standardeve të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), nga ana e Bashkisë Tepelenë”*.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave të komunitetit të grupeve të përjashtuara në Shqipëri (*duke përfshirë gratë, të moshuarit, fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje dhe shtresa të ulëta social-ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë romë, etj*).

Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së Bashku” pretendon mohimin e barazisë dhe diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara lidhur me mohimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara (PAK), në ambientet e Bashkisë Tepelenë, për shkak të mungesës së rampës.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore të aktit normativ, VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”, nëpërmjet të cilave PAK janë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Bashkisë Tepelenë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet:

*“1. Komisioneri ka kompetencë: ...b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”*.

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet se:

*“Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“Palë” është:

- a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;
- b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtëpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. ....

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative;
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”

Bazuar në nenin 33, pika 3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në këto dispozita ligjore rezultojnë se kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së Fondacionit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur.

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Fondacioni “Së Bashku”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, në kuadër të përfaqësimit të interesave të gjithë grupit të personave me AK, me status tetraplegjiku, të cilët janë përftitues të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se:

*“2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato*

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: ...

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1032/1 prot., datë 26.09.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrimet e dokumentacion provues<sup>2</sup>, subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Bashkisë Tepelenë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 1972/1 prot., datë 29.09.2023, Komisioneri është njohur me parashtrimet e Bashkisë Tepelenë, përse i takon problematikës së përcjellë nga subjekti ankues/Fondacioni, shkresë në të cilën, ndër të tjera, citohet se:

“...Bashkia Tepelenë bashkohet dhe e konfirmon këtë shqetësim të drejtë, por na duhet të shpjegojmë se përse gjendemi në këtë situatë:

---

<sup>2</sup>Respektivisht është kërkuar:

- Informacion dhe parashtrimet tuaja lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Cila është praktika e ndjekur nga ana juaj, lidhur me ofrimin e mundësisë për të aksesuar në mjediset e Bashkisë Tepelenë, për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të cilët në mungesë të një rampe për të hyrë në mjediset e saj, apo mungesës së elementëve të tjera të aksesueshmërisë për personat që nuk shohin, e kanë të pamundur marrjen e çfarëdolloj shërbimi të kërkuar prej tyre?
- Cilat janë masat e ndërmarra nga ana juaj lidhur me sa më sipër, për zgjidhjen e kësaj problematike (aksesueshmërisë nëpërmjet rampës dhe elementëve të tjera të aksesueshmërisë për personat që nuk shohin)? Parashtrimet dhe kopje të akteve provuese, nëse dispononi.
- Si dhe çdo informacion dhe dokumentacion provues, që ju çmoni se ndihmon në sqarimin e kësaj problematike të përcjellë nga ankuesi.

*Shërbimet për marrjen e certifikatave të Gjendjes Civile dhe pajisjen me pasaportë dhe kartë ID, kryheshin në një ambient që i plotësonte kushtet për marrjen e këtyre shërbimeve dhe aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara (PAK) tek ish-Prokuroria e Rrethit Tepelenë, me të cilën Bashkia kishte marrëdhënie kontraktuese, deri në vitin 2025, por, kjo marrëdhënie u ndërpre në mënyrë të njëanshme nga ana e Prokurorisë. Në këtë situatë, për vazhdimin e kryerjes së shërbimeve të ofruara, Bashkia Tepelenë u gjend në vështirësi për krijimin e ambienteve për të dhënë këto shërbime dhe për më tepër, ambiente që të plotësojnë kushtet për aksesueshmëri nga PAK.*

*Bashkia Tepelenë e ka vlerësuar këtë shqetësim të komunitetit dhe ka parashikuar në buxhetin e vitit 2024 “Rikonstrukcion të ambienteve të Njesisë Administrative Qendër”, ndodhur në katin e parë për t’u vënë në dispozicion këto shërbime.”*

2. Në vijim të kërkesës për dokumentacion provues lidhur me shqyrtimin e kësaj çështjeje, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1032/3 prot., datë 09.10.2023, ka kërkuar sërish nga Bashkia Tepelenë:
  - Kopje të dokumentit të planifikimit të buxhetit 2024, specifikisht zërit të planifikuar për rikonstrukcionin e ambienteve të Bashkisë Tepelenë, në përputhje me legjislacionin sa i takon kushteve për aksesueshmëri nga personat me aftësi të kufizuara, ku të jetë parashikuar në mënyrë të shprehur ndërtimi i rampës dhe elementëve të tjerë sipas përcaktimeve të VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””, si dhe koha e përfundimit të saj.
  - Me shkresën me nr nr. 2665/1 prot., datë 16.10.2023, Bashkia Tepelenë, ka dërguar kopje të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 80, datë 21.09.2023 “Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, të Bashkisë Tepelenë, bashkëlidhur edhe Tabelën nr. 3, të këtij Vendimi, me titull: “Tabela e investimeve për periudhën afatmesme 2024-2026, dokumenti i parë. Investimet nga transfertat e pakushtëzuar”.
3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1032/5 prot., datë 30.11.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, pranë Zyrës së Komisionerit.

Palëve iu bë e ditur se kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësohet se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Gjithashtu, Komisioneri, kërkoi paraprakisht nga ana e Bashkisë Tepelenë, të depozitojë gjatë seancës si më poshtë citohet:

- Dokumentin shkresor ku është parashikuar se sa është fondi i përcaktuar, i përlogaritur për ndërhyrjet ndërtimore në kuadër të aksesueshmërinë e ambienteve të godinës së Bashkisë, në zbatim të VKM nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, si dhe afatet për përfundimin e tyre.
- Kopje të dokumentit/preventivit apo projektit të miratuar, ku evidentohen specifikisht këto ndërhyrje, lidhur me aksesueshmërinë e godinës, në zbatim të VKM nr. nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Megjithëse referuar kuponëve të lajmërim marrjes, të shërbimit postar, palët kanë marrë dijeni për shkresën e njoftimit të seancës dëgjimore, në seancën dëgjimore me datë 13.12.2023, nuk u paraqit anjëra nga palët.

4. Në vijim të hapave proceduralë për shqyrtimin e çështjes në fjalë, si dhe në zbatim të parimit të gjykimit të drejtë e të arsyetuar, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 1032/6 prot., datë 14.12.2023, kërkoi sërish nga Bashkia Tepelenë, informacionin sipërcituar.
  - Me shkresën me nr. 2543/1 prot., datë 27.12.2023, Bashkia Tepelenë dërgoi pranë KMD-së, kopjen e Vendimit nr. 88, datë 30.11.2023 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2024”, bashkëlidhur edhe tabelën e investimeve për periudhën afatmesme 2024-2026.
5. Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Proçedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenit 39, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 2, datë 15.01.2024, të Komisionerit, në datën 26.01.2024, nga inspektorët e KMD-së, u realizura inspektimi në ambientet e Bashkisë Tepelenë.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, lidhur me parashikimet e bëra nga ana e Bashkisë Tepelenë, në kuadër të masave afatshkurtra apo afatmesme, për aksesueshmërinë e ambienteve të Bashkisë, nga ana e PAK, në zbatim të përcaktimeve të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””, duke qenë se në preventivin e punimeve për rikonstruksionin e objektit të Bashkisë Tepelenë, (bashkëlidhur shkresës me nr. 2543/1 prot., datë 27.12.2023) nuk evidentohet asnjë ndërhyrje lidhur me aksesueshmërinë për PAK.

<sup>3</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

Gjatë inspektimit me Nën/kryetaren e Bashkisë, znj. J. K, nga inspektorët e KMD-së, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua fakti se, gjithë informacioni i kërkuar nga Komisioneri, do të dërgohej brenda një afati kohor 2 (dy javor), pasi për shkak të ngarkesës së Bashkisë në këtë periudhë nuk ishte bërë i mundur disponimi i tij deri në datën e inspektimit.

6. Në vijim, nëpërmjet e-mailit datë 31.01.2023, Nën/kryetarja e Bashkisë Tepelenë, znj. J. K, ka dërguar pranë Komisionerit, Projekt-Zbatimin me objekt: “Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë. Relacioni PAK”

Ky dokument parashikon që objekti që rikonstruktohet shtrihet në qytetin e Tepelenës, pas objektit të Bashkisë Tepelenë, në një distancë prej 50 metrash nga qendra e qytetit. Në të citohet, ndër të tjera, se:

*“Përsa i përket rikonstruksionit të objektit, ky projekt është mbështetur përpos DP, në hartimin e preventivit, çmimet e referencës sipas legjislacionit në fuqi, në kushtet teknike të projektimit dhe standardet e Republikës së Shqipërisë (KTP, STASH, ENSTASH), në normat dhe rekomandimet e IEC, EV, dhe në VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 “Rregullore për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e PAK”*

*Rregullorja ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*

*Kjo Rregullore është mbështetëse për të gjitha projektet të cilat përfshijnë, objektet e reja që ndërtohen në territorin e Shqipërisë, qofshin ato objekte publike të ndërtuara me fonde të buxhetit të shtetit apo fonde private, qofshin ato objekte private, në hapësirat publike dhe ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në hapësirat publike dhe objektet ekzistuese nëse ato i nënshtrohen rikonstruksionit, ashtu si dhe në rastin e rikonstruksionit të Njesisë Administrative Qendër, të sipërpërmendura.*

*Krijimi i faciliteteve për kategorinë PAK që mund të jenë pjesë e kujt do grup moshe, ka konsistuar në vendosjen e rampave me pjerrësi 4-6% atje ku është e nevojshme për të arritur nivelet e ndryshme të godinës, tualetet me përmasa dhe pajisjet përkatëse për këtë kategori, si dhe vende të posaçme në ambientet e Njesisë Administrative. Realizimi i elementëve të nevojshëm për aksesin e PAK do të shtrihet edhe në sistemet e jashtme.*

*Qartë, edhe nga planimetria e objektit në katin përdhe dhe katin e parë, shohim se normativat e Rregullores janë respektuar për secilën njëj sanitare në secilin kat, duke përfshirë hapësirën e mjaftueshme të dimensioneve të karrocave.*

*...Hapësirat e jashtme që iu përkasin ndërtesave, kusht i domosdoshëm i arritshmërisë quhet i plotësuar nëse ekziston të paktën një rrugë për hyrje në ndërtesë, e shfrytëzueshme edhe nga ana e PAK, përdorues të karrigeve me rrota dhe ndijues.*



*Objektivi ynë e plotëson këtë kusht. Hyrja frontale e ndërtesës është e aksesueshme nga PAK, pasi rampa në hyrje të ndërtesës krijon pjerrësinë e përshtatshme ashtu si në detajet e fotos bashkëlidhur. Në rastin tonë, godina nuk ka shkallë, por një lartësi afërsisht 8 cm nga kuota e rrugës së aksesit për në objekt. Prandaj dhe hyrja është menduar si në foto, me material beton ose gomë.*

*Rrugët në hapësirat e jashtme, që të çojnë të hyrja e ndërtesës, duhet të paktën një prej tyre të parashikohet me karakteristikat që lejon lëvizjen e PAK, me qëllim që tu garantojë atyre persodimin e pajisjeve, të parkimeve dhe të shërbimeve të tyre dhe të shërbimeve të vendosura jashtë ndërtesës.*

*Rrugët sigurojnë një ecje sa më të rehatshme dhe të lehtë për në hyrje të ndërtesës, pa ngushtime, pajisje, pengesa të natyrshme, të cilat zvogëlojnë gjerësinë e kalimit ose që mund të shkaktojnë dëmtime fizike të përdoruesit të karriges me rrota.*

*...lidhur me normativat e Rregullores në fjalë, projekti sa më sipër është bërë në përputhje me rregullat e përcaktuara në të, duke mundësuar ofrimin e aksesit për PAK. Për çdo përshtatje të mundshme, do të lihet hapësirë për ndryshime edhe në zbatimin e punimeve, me konsulencë dhe miratim nga mbikqyrësi i punimeve.”*

7. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit dhe transparencës, Fondacionit “Së Bashku”, i është përcjellë nëpërmjet e-mailit, dokumenti i dërguar nga Bashkia Tepelenë, Projekt-Zbatimi me objekt: “Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë. Relacioni PAK”
8. Pasi është njohur me dokumentin sipërcituar, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku”, znj. L, nëpërmjet emailit të dërguar me datë 05.02.2024, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar reagimin e Bashkisë dhe masat e ndërmarra prej saj, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, në kuadër të zbatimit të projektit: “Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Tepelenë. Relacioni PAK”, për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së aksesueshmërisë në zbatim të kriterëve teknike të përcaktuara në VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e

*nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 180, datë 25.09.2023, të Fondacionit “Së Bashku”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Bashkia Tepelenë, në përfundim të rikonstruksionit të godinës së Njesisë Administrative Qendër, (në zbatim të Projekt-Zbatimit, me objekt: “Rikonstruksion objekti, Njësia Administrative Qendër, Bsshkia Tepelenë, Relacioni PAK”), të informojnë Komisionerin lidhur me zbatimin e kriterëve të aksesueshmërisë, sipas VKM nr. 1503, datë 19.11.2003 “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””. Të depozitojnë pranë KMD-së dokumentacionin përkatës dhe fotot ilustruese, lidhur me respektimin e kriterëve teknike e ligjore të aksesueshmërisë, sipas VKM-së respektive.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja djeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**